



C1-EU-NPA

CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA

DOKUMENT QËNDRIMESH

“Masat e ndërmarra nga aktorët përgjegjës për garantimin e dinjitetit njerëzor të shtetasve të zhdukur dhe atyre të humbur gjatë regjimit komunist në vendin tonë”



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri”, zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Rishikoi:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Drejtuese e Klinikës së Ligjit/Menaxhere Projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
2. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përpunim statistikor i të dhënave nga korrespondenca me institucionet:

1. Znj. Eriselda Ndreca, Paraligjore/Asistente projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752 Tel: 04 2233671
Mob: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al
website: www.ahc.org.al



Tabela e përmbajtjes

Akronime	3
<i>I.Sfondi</i>	<i>4</i>
<i>II. Kuadri ligjor dhe rregullator</i>	<i>6</i>
<i>III. Vlerësime të institucioneve ndërkombëtare</i>	<i>9</i>
1. <i>Qëndrime të Komisionit Evropian</i>	<i>9</i>
2. <i>Qëndrime të Komisionit Ndërkombëtar për Shtetasit e Zhdukur</i>	<i>9</i>
<i>IV. Gjetjet</i>	<i>11</i>
1. <i>Analiza e zbatimit të kuadrit ligjor</i>	<i>11</i>
a. <i>Masat administrative</i>	<i>11</i>
<i>Krijimi një mekanizmi të qëndrueshëm dhe efektiv koordinimi</i>	<i>11</i>
<i>Ndryshimet në organizimin e brendshëm të AIDSSH</i>	<i>12</i>
<i>Krijimi i databazës së të dhënave</i>	<i>12</i>
<i>Hetimi administrativ i rasteve</i>	<i>13</i>
<i>Veprimtari të tjera</i>	<i>15</i>
b. <i>Ndjekja penale</i>	<i>15</i>
2. <i>Roli i shoqërisë civile</i>	<i>17</i>
<i>IV. Rekomandime</i>	<i>18</i>
<i>V. Literatura</i>	<i>19</i>



Akronime

Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit – AIDSSH

Komiteti Shqiptar i Helsinkit – KShH

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit – KPK

Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur – ICMP

Instituti i Mjekësisë Ligjore – IML

Ministria e Punëve të Brendshme – MPB



I.Sfondi

Çdo shtet demokratik, në themel të vlerave të të cilit qëndron dinjiteti njerëzor, ka përgjegjësi për të krijuar mekanizma efektivë që sigurojnë paqen e qëndrueshme sociale dhe përpunimin e ballafaqimin me pasojat e së shkuarës. Pjesë e kësaj përgjegjësie është edhe gjetja e personave të zhdukur si dhe hedhja dritë mbi rrethanat individuale të zhdukjes të tyre. Zbardhja e fatit të personave të zhdukur i shërben vendosjes së drejtësisë për të gjithë familjarët e tyre.

Gjatë regjimit komunist, vlerësohet se rreth 6,000 persona u zhdukën në Shqipëri. Sipas të dhënave zyrtare rreth 5,501 persona të dënuar për arsye politike, u ekzekutuan gjatë kësaj periudhe¹ dhe trupat e tyre nuk u kthyen kurrë në familjet e tyre. Të dhënat zyrtare tregojnë gjithashtu se 987 të burgosur politikë vdiqën nga shkaqe të ndryshme në burgje dhe qendra të paraburgimit në Shqipëri², ndërkohë që vendndodhja e mbetjeve të tyre mortore është e panjohur për të afërmit që mbijetuan.

Nga një pyetësor i publikuar online nga Fondacioni Kujto, me familjarët e 175 viktimave të zhdukura gjatë komunizmit, ku më shumë se gjysma (**55%**) pohuan se kishin kryer kërkime private në institucionet shtetërore dhe në arkiva për të zbuluar fatin e të afërmit të zhdukur, ndërsa **45% thanë se nuk kishin kryer kërkime**.³ Më tej, rreth **71%** e familjarëve që kishin kryer kërkime dështuan që t'i gjenin vendvarrimet, ndërsa vetëm **29% i kishin gjetur ato; 50% e familjarëve** deklaruan se të afërmit e tyre ishin pushkatuar me ose pa gjyq gjatë regjimit komunist, ndërsa 23% deklaruan se kishin vdekur gjatë vuajtjes së dënimit në burg ose në internim. Rreth **7% raportuan si shkak të vdekjes torturat** në hetuesi, ndërsa **6% ekzekutimet në kufi**. Rreth **62%** e të anketuarve deklaruan se kishin kërkuar ndihmën e autoriteteve, të tilla si Ministria e Brendshme, Autoriteti i Dosjeve apo policia. Megjithatë, **61% e vlerësuan me notë negative** reagimin e këtyre institucioneve.

Pavarësisht shifrave të gjithëpranuara, krijimi i premisave ligjore për gjetjen, indentifikimin dhe rikuperimin e të zhdukurve filloi vetëm në vitin 2007 me miratimin e Ligjit nr. 9802, datë 13.9.2007, “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së ‘Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë’”.

¹ Raport i ICMP “Shqipëri, Personat e Zhdukur gjatë Periudhës Komuniste: Vlerësimi i Nevojave”, 2021, fq.4, <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-wb-152-6-alb-W-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>

² Po aty

³ Kërkimet për viktimat e zhdukura të komunizmit, peng i përplasjes mes institucioneve, <https://kujto.al/kerkimet-per-viktimat-e-zhdukura-te-komunizmit-peng-i-perplasjes-mes-institucioneve/>



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u krijua në vitin 2015, pas miratimit të ligjit nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në Korrik 2020, Kuvendi vendosi fuqizimin e rolit të Autoritetit dhe zgjerimin e kompetencave duke përfshirë bashkëpunimin me institucionet shtetërore qendrore dhe lokale për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për të marrë masa për të mbrojtur dhe për të ruajtur në mënyrë adekuate vendet që aktualisht janë identifikuar ose do të identifikohen si vendet e varrimit.

Në total janë **280** (dyqind e tetëdhjetë) kërkesa të regjistruara pranë Autoritetit për periudhën **2017-2023**, për qartësimin e fatit të të zhdukurve⁴. Kjo përbën vetëm 4.5% të rasteve të personave të dënuar për arsye politike, që u ekzekutuan gjatë regjimit komunist.

Rreth 17 vjet më vonë, megjithë krijimin e një kuadri ligjor dhe rregullator në përputhje me standardet më të mira, gjetja, identifikimi dhe rikuperimi i trupave të të zhdukurve, ende nuk ka mundur të ngrihet në nivelin e një sistemi efektiv dhe me rezultate të qënësishme (*track record*). Është fakt i gjithëpranuar nga të gjithë aktorët që në ato pak raste kur është mundur të indentifikohet dhe zbulohen trupat, kjo ka ardhur si ndërmarrje private e familjarëve. Që në krye të herës ky proces ka qenë i natyrës ‘*private*’, administruar tërësisht nga familjarët e viktimave të cilët për shumë arsye kanë preferuar të mos përfshijnë struktura shtetërore.

⁴ Raporti i Autoritetit pwr vitin 2023



II. Kuadri ligjor dhe rregullator

Shqipëria ka ratifikuar KEDNJ në vitin 1996 që parashikon mbrojtjen me ligj të së drejtës së jetës, dhe krijon një detyrim procedural për të kryer hetime (neni 2). Qëllimi thelbësor i një hetimi në bazë të nenit 2, si instrument ndërkombetare i të drejtave të njeriut, është të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve vendase për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe të sigurojë llogaridhënie.

Miratimi i Ligjit nr. 9802, datë 13.9.2007, “*Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së ‘Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë’*” parashikon detyrime të tjera specifike në lidhje me gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve.

Rreth 10 vite më vonë, në 18.07.2018, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ka nënshkruar me ICMP një marrëveshje e bashkëpunimit që ka hyrë në fuqi në datën 03.05.2019⁵. Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i sferave të bashkëpunimit midis palëve dhe ushtrimin e funksioneve të ICMP-së, ngritjen e Zyrës së ICMP-së në Shqipëri, statusin e ICMP-së në Shqipëri dhe mënyrën e funksionimit, statusin dhe trajtimin e Komisionerëve, zyrtarëve dhe ekspertëve të ICMP-së.

Ndryshimet e miratuara në Korrik 2020 në ligjin nr. 45/2015 “*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, përcaktuan Autoritetin e Dosjeve si institucionin koordinues, përgjegjës për të bashkëpunuar me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe për të ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime (neni 22 pika 1). Më tej, përcaktohet se rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit dhe institucioneve qendrore dhe vendore për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit parashikohen në marrëveshje dy apo shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim (pika 2). Këshilli i Ministrave ngarkohet të miratojë një vendim që përcakton autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara (pika 3). VKM e përmendur më sipër nuk është miratuar ende. Miratimi i këtij akti konsiderohet nga vetë Autoriteti si vendimtar⁶, pasi kuadri ligjor aktual përcakton institucionet përgjegjëse, por nuk parashikon teknikat se si duhet të zhvillohet i gjithë procesi, si dhe ‘peshën’ që do të mbaj secili institucion në këtë proces zinxhir.

⁵ Publikuar në Fletorën Zyrtare nr.67, datë 10.05.2019

⁶ Po aty, fq.37



Vlen të theksohet se ndryshimet në Ligjin 45/2015 për herë të parë sigurojnë një përkufizim të një personi të zhdukur në legjislacionin shqiptar⁷. Neni 4 thotë se “*një person i zhdukur është një person i arrestuar, burgosur, rrëmbyer ose privuar nga liria e tij/saj në ndonjë formë tjetër nga agjentët e shtetit ose nga persona të tjerë ose grupe personash, të cilët kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, i ndjekur nga mohimi i pranimin të heqjes së lirisë ose fshehja e fatit të personit të zhdukur ose vendit ku ai/ajo ndodhet, duke e shkëputur atë nga mbrojtja e ligjit*”. Ndërsa personat e zhdukur më parë nga epoka komuniste ishin përcaktuar ligjërisht si “*të përndjekur politik*”, ndryshimet e lartpërmendura kodifikojnë njohjen e çështjes së personave të zhdukur për arsye të pavullnetshme nga ligjvënësi.

Gjithashtu, Autoriteti në funksion të hetimit administrativ, “Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, mund: a) *Të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin e individëve, që ofrojnë informacion si persona të përfshirë ose në dijeni për rrethanat e çështjes; b) Të marrë materiale të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) Të vizitojë dhe të kontrollojë sende apo vende të që kanë të bëjnë me procesin*” (neni 5, pika 1.1 me paragrafet “a”, “b” dhe “c”). Më tej në paragrafin 1.2 të nenit 5, përcaktohet që çdo person është i detyruar të bashkëpunojë me Autoritetin kur rezulton se ka dijeni për rrethanat e çështjes, i kërkohet informacion si person i përfshirë ose që ka dijeni për rrethanat e çështjes, apo kur ai vetë disponon informacion që e ndihmon Autoritetin në punën e tij. Autoriteti në zbatim të këtij ligji ka detyrimin të garantojë konfidencialitetin për çdo person që bashkëpunon.

Krijimi, pasurimi, aksesimi në arkivat e institucioneve të ndryshme shtetërore (Arkivin e Shtetit, Arkivin e MPB-së, Arkivin e Shërbimit të Inteligjencës, Muzeun Kombëtar, Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Komunizmit në Shqipëri) dhe përditësimi i arkivës së vetë AIDSSH përbën një element thelbësor që lidhet (jo vetëm me ushtrimin e kompetencave të tjera që gëzon autoriteti) edhe me ushtrimin e kompetencës për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit.

Pavarësisht se AIDSSH ka rol iniciues dhe koordinues në këtë proces delikat, ku ndërthurren elementë administrativ dhe penal⁸, zbatimi i parashikimeve ligjore nuk është vetëm përgjegjësi e

⁷ Raport i ICMP “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: Vlerësimi i Nevojave”, 2 Mars 2021, fq.11 <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-wb-152-6-alb-W-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>

⁸ Kodi i Procedurës Penale parashikon detyrimin e prokurorit për të zhvilluar dhe kontrolluar hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe të kryejë çdo veprim hetimor që ai vlerëson si të domosdoshëm (neni 24), i cili përfshin urdhërimin e zvarrosjes së mbetjeve njerëzore, në mënyrë që të mundësojë ekzaminimin e mbetjeve njerëzore nga prokurori në prani të një mjeku ligjor (neni 200). Në përputhje me Kodin, institucionet e vetme kompetente që mund të bëjnë një gërmim në përputhje me standardet e sundimit të ligjit janë zyrat e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të riorganizuar sipas hartës së re gjyqësore.



këtij institucioni. Ky është një proces xhinxhir dhe kompleks që karakterizohet nga ndërveprimi i disa institucioneve me kompetenca kushtetuese (si prokuroria për hetimi penal), ligjzbatuese (policia e shtetit), territoriale (njësitë e vetëqeverisjes vendore) apo edhe të veçanta teknike (Instituti i Mjekësisë Ligjore). Për këtë arsye, ligji i lartpërmendur që rregullon kompetencat e AIDSSH duhet lexuar në harmoni me parashikimet e tjera ligjore në fuqi⁹, duke përfshirë kodet procedurale. Kështu lipset bashkëpunim ndërinstitutional në fazën *para* gërmimit dhe *pas* gërmimit.

Faza *para* gërmimit nënkupton veprime që lidhen me mbledhjen e informacioneve mbi vendndodhjen, kqyrjen e vendit, veprimet procedurale sipas kodeve, si dhe gërmimin. Ndërkohë që faza *pas* gërmimit, në rastin e gjetjes së kufomave, nënkupton ekzaminimin mjeko-ligjor, marrjen e mostrës, testimi i përputhshmërisë dhe procesi i identifikimit zyrtar të personit të zhdukur.

Ndërveprimi i suksesshëm midis të gjithë institucioneve është vendimtar për suksesin tërësor të procesit të gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të trupave. Parë nga një këndvështrim më macro, rezultatet e vetëm një institucioni do të mbeten modeste për procesin në tërësi, nëse nuk shoqërohen me veprimet e institucioneve të tjera përgjegjëse. Mosmiratimi i VKM-së është bërë pengesë për zhvillimin e një procesi tërësor, në frymën e ligjit, që kurorëzohet me rezultate konkrete dhe të matshme.

Të gjitha iniciativat e ndërmarrja nga qeveria për mirëqeverisjen, forcimin e institucioneve shtetërore, të shtetit të së drejtës nuk mund të shpalosin potencialin e tyre të plotë nëse kufizohen nga e kaluara e dhimbshme e shtetit. Për këtë qëllim shteti duhet të inkurajojë dhe lehtësojë debatin publik mbi trashëgimiminë e të shkuarës komuniste dhe se si me angazhimin e të gjithëve mund të tejkalohen pasojat e dhimbshme¹⁰.

Pavarësisht se ndërveprimi midis të gjitha institucioneve nuk ka arritur ende nivelet e dëshiruara dhe kërkuara nga institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe aktorët e tjerë, Autoriteti ka vijuar me ndërmarrjen e të gjitha hapave të tjerë brenda sferës së vet të kompetencës. Kështu, për rregullimin më të detajuar të procedurave dhe metodologjisë së kryerjes së verifikimeve administrative, me vendimin nr.625/10, datë 30.03.2023 Autoriteti ka miratuar Udhëzuesin “Për rregulla dhe procedura të verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumente e ish-sigurimit të shtetit.

⁹Instituti i Mjekësisë Ligjore krijuar fillimisht në 2003, është riorganizuar tërësisht me VKM nr.680, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të institutit të mjekësisë ligjore”

¹⁰ Preliminary observations of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances at the conclusion of its visit to Albania (5-12 December 2016) | OHCHR, <https://www.ohchr.org/en/statements/2016/12/preliminary-observations-working-group-enforced-or-involuntary-disappearances>



III. Vlerësime të institucioneve ndërkombëtare

1. Qëndrime të Komisionit Evropian

Komisioni Evropian në Raportin Screening 2023¹¹ pasi analizon të gjitha zhvillimet politike dhe ligjore në lidhje me këtë çështje, evidenton se kuadri ligjor ekzistues duhet të forcohet më tej. Më tej, theksohet rëndësia e alokimit të burimeve të mjaftueshme (financiare dhe njerëzore) për sa i takon procesit të identifikimit si dhe formalizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Së fundmi, inkurajohen institucionet që të hartojnë një bazë të dhënash të vetme, të harmonizuar dhe tërësore për të gjithë personat e zhdukur, e aksesueshme për publikun.

2. Qëndrime të Komisionit Ndërkombëtar për Shtetasit e Zhdukur

Komisioni në raportin e vitit 2021 ka paraqitur një sërë rekomandimesh të detajuara që lidhen me:

- Miratimin e legjislacionin i cili përfshinë parashikimet për mbrojtje të drejtave të familjeve të personave të zhdukur. Ligji duhet të mbështesë të drejta të tjera jomateriale të familjeve, siç është përkujtimi i datave të rëndësishme ose në vendet me rëndësi.
- Qeveria duhet të sigurojë që Autoritetit t'i miratohen burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore në mënyrë që të mund të koordinojë aktivitetet që kanë të bëjnë me hetimet dhe identifikimin e të gjithë personave të zhdukur nga periudha komuniste.
- Në mënyrë që Autoriteti të përmbushë rolin e tij në përputhje me ndryshimet në Ligjin nr.45/2015, Këshilli i Ministrave duhet të hartojë pa vonesë aktin nënligjor normativ të nevojshëm për funksionimin efektiv të departamentit të ri për personat e zhdukur brenda Autoritetit.
- Legjislacioni dytësor duhet të mandatojë Autoriteti për të krijuar dhe mirëmbajtur një bazë të dhënash të vetme, të harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse të personave të zhdukur. Kjo do të lejonte shtetin të sigurojë informacion të saktë dhe të besueshëm në lidhje me rastet e personave të zhdukur. Një bazë e të dhënave do të jetë thelbësore në forcimin e kapacitetit të shtetit për të gjetur të zhdukurit dhe për të lejuar familjet të regjistrojnë të afërmit e zhdukur dhe të ushtrijnë të drejtat e tyre sociale dhe ekonomike. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që të gjitha institucionet, organizatat joqeveritare dhe individët që posedojnë informacione mbi personat e zhdukur të sigurojnë të dhëna në posedim Autoritetit që do t'i organizojë, menaxhojë dhe verifikojë ato.
- Autoriteti duhet të sigurojë mbikëqyrjen publike të aktiviteteve të tij, veçanërisht në lidhje me familjet e të zhdukurve, gjë që do të rrisë nivelin e tyre të besimit në veprimet e tij.

¹¹https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf



- Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka një numër të mjaftueshëm të prokurorëve për të ofruar një përgjigje zyrtare për varret klandestine dhe vendet e kimit nga epoka komuniste, në bashkëpunim me institucionet përkatëse ekzistuese.
- Autoritetet shqiptare duhet të ndajnë burime të mjaftueshme për IML për ekzaminimin dhe identifikimin e rasteve të personave të zhdukur në përputhje me standardet ndërkombëtare të mjekësisë ligjore dhe për ruajtjen e duhur të mbetjeve njerëzore deri në varrosjen e tyre.

Këto rekomandime janë adresuar pjesërisht për sa i takon nivelit të llogaridhënies nga ana e Autoritetit dhe rritjes së besimit të familjarëve në këtë institucion. Megjithatë, ende shumë mbetet për të bërë nga institucionet e tjera (Këshilli i Ministrave, Parlamenti dhe Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm) për realizimin tërësor të tyre.



IV. Gjetjet

1. Analiza e zbatimit të kuadrit ligjor

Pavarësisht kuadrit ligjor në fuqi dhe detyrimeve të organeve përkatëse, deri më tani, është vërejtur një pamundësi e institucioneve dhe aktorëve për ta zgjidhur bashkërisht këtë çështje¹². Procesi vlerësohet se është në hapat fillestarë që lidhen me fazën *para* gërmimit.

Pavarësisht sfidave për të cilën të gjithë institucionet dhe aktorët janë të vetëdijshëm, ka patur zhvillime inkurajuese si akreditimi aktual që po i bëhet Policisë Shkencore, sa i përket laboratorit nëpërmjet mbështetjes nga donatorë të huaj.

a. Masat administrative

Krijimi një mekanizmi të qëndrueshëm dhe efektiv koordinimi

Në zbatim të parashikimeve të reja ligjore, AIDSSH ka nënshkruar në datën 03.02.2022, marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për garantimin dhe realizimin e një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën gjatë periudhës së komunizmit.¹³ Nga kqyrja e faqes zyrtare të Autoritetit nuk rezulton që të jenë nënshkruar marrëveshje të tjera bashkëpunimi.

Pavarësisht ekzistencës së marrëveshjes, Autoriteti ka kërkuar informacion nga një sërë institucioneve ku rezulton që numri i përgjigjeve me të dhëna të kthyer nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve apo Drejtoria e Arkivit mbetet i ulët.

Pozitiv është bashkëpunimi i vendosur midis Autoritetit e bashkive përta i përket ruajtjes së 107 vendvarrimeve të hartëzuara. Kështu, referuar informacioneve të vëna në dispozicion nga Autoriteti¹⁴, takimet në Bashkinë Shkodër, Mirditë, Ersekë, Fushë-Arrëz, si dhe veprimtaritë e përbashkëta me këto institucione vendore, materializuar me shënjestimin e vendvarrimeve të dyshuara, apo në ndonjë rast në rrëzimin e alibisë për ekzistencën e tyre, krijonë premisa të mira për arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Referuar parashkrimeve të Autoritetit, është në proces nënshkrimi i një marrëveshje trepalëshe mes tij, Ministrisë Brendshme dhe ICMP-së, me të cilën synohet dakortësimi për rolin në proces të secilit institucion që në këtë fazë si dhe vendosjen e një bashkëpunimi ndërveprues përmes

¹² Parashtrim i Kryetares së AIDSSH në eventin e datës 5 Mars 2024.

¹³ Raport Vjetor 2022, fq.15

<https://autoritetidosjeve.gov.al/uploads/raporti%20faqosje%202022%20print%20ok.pdf>

¹⁴ “Raporti “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, gjatë vitit 2023”



shkëmbimit të informacionit duke e bërë punën e secilit më të dobishme në shërbim të procesit të identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur.

Tryezat e organizuara me mbështetjen e donatorëve¹⁵ mbeten një mjet i rëndësishëm për t'u koordinuar dhe ndërvepruar me institucionet e tjera (Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Instituti i Mjekësisë Ligjore, dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur). Referuar Raportit Vjetor 2022, në këto takime janë hedhur piketa se cili institucion/organ është përgjegjës për zbatimin e procedurave hap pas hapi dhe çfarë duhet të përmbajë në vetvete draft-VKM-ja përkatëse. Këto organizime nuk duhet të mbeten sporadike, por duhet të shndërrohen në një mekanizëm koordinimi të qëndrueshëm dhe efektiv.

Ndryshimet në organizimin e brendshëm të AIDSSH

Në zbatim të parashikimeve ligjore të lartpërmendura, Autoriteti ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për riorganizimin e brendshëm duke krijuar Drejtorinë e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur¹⁶. Kjo strukturë në përbërjen e të cilës janë 5 persona, është funksionale dhe përgjegjëse për komunikimin administrativ ndërmjet institucioneve përgjegjëse që janë të përfshira në proces.

Bazuar në kërkesat e familjarëve, kjo drejtori ka filluar trajtimin e rasteve për kërkime vendvarrimesh për të zhdukur, për të cilët ka patur dhe ka akoma dëshmitarë okularë apo të tjerë persona që kanë të dhëna rreth fatit të tyre. Më tej, Drejtoria¹⁷, për të gjitha kërkesat nga të afërm të personave të zhdukur, ka kryer disa kërkime si në Drejtorinë e Arkivit në Autoritet, në Ministrinë e Brendshme apo dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duke bërë në kohë vlerësimin e përgjigjeve dhe regjistrimin e tyre në një bazë të dhënash që përditësohet. Pjesë e punës së Drejtorisë është edhe skanimi i të gjitha praktikave për të lehtësuar kërkimin dhe gjetjen e të dhënave që ndihmojnë procesin e identifikimit, rikuperimit dhe qartësimin të fatit të të zhdukurve.

Krijimi i databazës së të dhënave

AIDSSH ka ngritur një databazë të brendshme funksionale¹⁸, por ajo çfarë ende nuk është realizuar, që përbën edhe sugjerim të ICMP, është krijimi i një databaze të uniformizuar të institucioneve përgjegjëse, në aksesimin e njëkohshëm të të dhënave. Kjo nënkupton që Drejtoria

¹⁵ Referuar Raportit Vjetor 2022, prezenca e OSBE në Shqipëri ka organizuar disa tryeza teknike pune mbi identifikimin dhe rikuperimin e trupave të personave të zhdukur gjatë periudhës komunizmit, (4 Nëntor 2021, 22 shkurt 2022 dhe 6 Prill 2022, etj) në periudha të ndryshme kohore.

¹⁶ Raport Vjetor 2022, fq.36,

<https://autoritetidosjeve.gov.al/uploads/raporti%20faqosje%202022%20print%20ok.pdf>

¹⁷ Këto të dhëna janë vanë në dispozicion nga vetë AIDSSH në vijim të gjetjeve të konstuara dhe diskutimeve në tryezën e datës 5 Mars 2024.

¹⁸ Parashtrim i Kryetares së AIDSSH në eventin e datës 5 Mars 2024.



ka përditësuar databazën në format Excel me të dhënat e detajuara për personat e zhdukur në raport me personat kërkues, duke përmbushur sa është e mundur, një hap të parë në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur, dhe që i shërben pozitivisht administrimit e organizimit të brendshëm të këtij procesi.

Edhe në rastin e krijimit të databazës evidentohet që ky është proces kompleks, ku lipset kontributi dhe përgjegjshmëria e të gjithë institucioneve të përfshira në mënyrë që të hapat që hidhen të kenë efektin e dëshiruar. Sërish edhe ky proces lidhet me miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë peshën që mban çdo institucion.

Hetimi administrativ i rasteve

Një hetim efektiv matet me katër standarde: pavarësinë, përshtatshmërinë, shpejtësinë dhe kontrollin publik. Këto standarde janë krijuar përmes jurisprudencës të GJEDNJ-së në çështjet që kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 2 të KEDNJ-së¹⁹. GJEDNJ ka theksuar që se në bazë të nenit 2 të KEDNJ-së hetimet për shkelje të pretenduara nuk mund t'u lihen të afërmeve të viktimave, por duhet të kryhen nga autoritetet sipas detyrës zyrtare. Në të gjitha rastet familjarët nuk mund të lejohen t'i kryejnë këto procedura privatisht dhe pa asnjë përfshirje të shtetit.

Në total janë **280** (dyqind e tetëdhjetë) kërkesa të regjistruara pranë Autoritetit për periudhën **2017-2023**, për qartësimin e fatit të të zhdukurve, dhe numri i kërkesave gjatë vitit 2023 vazhdon të jetë një shifër më e lartë se mesatarja e kërkesave në vite, që tregon që familjarët po e vlerësojnë si mundësi bashkëpunimin me Autoritetin²⁰. Ky numër përbën vetëm 4.5% të rasteve të personave të dënuar për arsye politike, që u ekzekutuan gjatë periudhës së regjimit komunist. Këto shifra mbeten modeste duke konfirmuar hezitimin e familjarëve për t'iu drejtuar autoriteteve shtetërore dhe duke e konsideruar këtë proces si një ndërmarrje private. Pavarësisht kësaj, është inkurajues fakti që pas gjithë këtyre viteve, familjarët besojnë që mund të qartësojnë fatin e të zhdukurve nëpërmjet AIDSSH.

Rezultun se në vitin 2023 Autoriteti ka miratuar 3 vendime²¹ lidhur me hetimet administrative si më poshtë:

- (i) Vendimin **nr.372, datë 30.05.2023**²², për fillimin e hetimit administrativ me qëllim verifikimin dhe qartësimin e rrethanave dhe fakteve mbi të pagjeturit për rastet e para;

¹⁹ *Al-Skeini and Others v. the United Kingdom*- 55721/07 datë 7.7.2011

²⁰ Të dhënat e vëna në dispozicion nga Autoritet, pjesë e Raportit Vjetor 2023.

²¹ Kopje të këtyre vendimeve i janë vënë në dispozicion KShH për efekt të këtij Raporti nga ana e Autoritetit.

²² Njoftim për shtyp në faqen zyrtare të Autoritetit, <https://autoritetidosjeve.gov.al/blog/aidssh-nis-hetimin-administrativ-per-verifikimin-e-vendvarrimeve-te-fshehta-dhe-qartesimin-e-fatit-te-44-te-zhdukurve-ne-burgun-e-spacit>



- (ii) Vendimin **nr.374, datë 02.06.2023** për fillimin e hetimit administrativ me qëllim qartësimin e fatit, gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit;
- (iii) Vendimin **nr.535, datë 29.08.2023** për miratimin e fillimit të procedurës së verifikimit të thelluar administrativ me qëllim identifikimin e vendvarrimeve të personave të vdekur ose të zhdukur në Shkodër gjatë regjimit komunist si dhe qartësimin e fatit, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të tyre.

Fillimi i hetimeve për çështje (vendvarrime) konkrete dëshmon vullnetin AIDSSH që pavarësisht kuadrit ligjor të paplotë, të ndërmarrë hetime administrative brenda kompetencave të parashikuara në ligj.

Në lidhje me **burgun e Spaçit**, Autoriteti ka ngritur grupe pune të cilët kanë marrë dëshmi nga ish të dënuar politikë, nga familjarë të personave të vrarë apo vdekur në burgje, nga ish punonjës të policisë së burgut të Spaçit dhe nga ish punonjës të lirë. Ky hetim lidhet me qartësimin e fatit të 44 (dyzetekatër) të zhdukurve të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit në këtë burg. Grupet e punës kanë takuar edhe familjarë që i kanë gjetur në vitet e para të demokracisë, eshtrat e të afërmeve të tyre të vrarë apo vdekur në burg; duke shkuar me ta edhe në vendvarrimin ku i kanë gjetur eshtrat, duke njohur dhe mësuar kështu përvojën e tyre. Janë bërë vizita verifikuese në terren duke konkluduar deri edhe me shënjestime për vend-varrime të dyshuara, për të cilët është bërë edhe përcaktimi koordinatave sipas Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapsinor. Paralelisht, Autoriteti ka vazhduar komunikimet me Shoqatën e Ish të Përsekutuarve dhe Përndjekurve Politikë, duke marrë prej tyre të dhëna e dëshmi për vende të dyshuara si vendvarrime me eshtra të të zhdukurve.

Një tjetër hetim administrativ lidhet me gjetjen e eshtrave të të zhdukurve në **Shkodër, pranë varrezave të Rrmajit**. Përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër, Drejtorinë e Policisë Shkodër, Kishën Katolike të Shkodrës, është arritur të rrethohet plotësisht ky vendvarrim i dyshuar, duke vendosur në të një tabelë informuese (shenjzim) në të cilën Autoriteti dhe Bashkia Shkodër theksojmë paprekshmërinë apo mostjetërsimin e kësaj pjese territori, deri sa të jenë kryer në të kërkimet dhe gërmimet për eshtrat e të zhdukurve.

Një tjetër angazhim i Autoritetit lidhet edhe me evidentimin e të vrarëve në kufi gjatë regjimit komunist, qartësimi i fatit deri dhe gjetjen e eshtrave të tyre, **në zonën e Ersekës**, si një vend me raste të shumta të vrasjeve dhe vdekjeve të shqiptarëve, gjatë përpjekjeve për të kaluar kufirin.

Gjithashtu, nisur nga kërkesat e familjarëve të personave të zhdukur, Autoriteti ka kryer kërkime dhe vizita në vende të dyshuara, për të cilat janë marrë edhe dëshmi nga persona që kanë dijeni rreth tyre si në Mallkeq Bashkia Selenicë, Shën Vasil bashkia Sarandë, Vorfë Njësia Administrative



Gruemirë, Bashkia Malësi e Madhe, Kërpicë, Bashkia Gramsh, Grekan, Njësia Administrative Sulovë, Elbasan, Shelegur, Bashkia Leskovik. Për këto raste, përmes dëshmimeve të personave që kanë patur dijeni, dhe vizitave në vendet e dyshuara si vendvarrime, është arritur lokalizimi i vendeve të dyshuara si vendvarrime, është bërë shënjestimi i kordinatave të tyre si dhe realizimi i bar kodit për secilin rast sipas Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor Shqiptar.

Veprimtari të tjera

Memorialet e organizuara nga strukturat shtetërore apo me mbështetjen e tyre kanë rëndësi të veçantë në funksion të ruajtjes së memories kolektive⁴.

Përveç veprimtarive të përmendura më sipër, rezulton që Autoriteti ka ndërmarrë hapa për krijimin e një kulture përkujtimore nëpërmjet ndërtimit të memorialeve në nderim të të vrarëve dhe zhdukurve nga diktatura, si në burgje, kampe, hetuesi apo edhe në kufi, si për shembull në Rehovë, Leskovik. Vende të tjera përfshijnë edhe memorialet në Tepelenë dhe Maliq.

Qëllimi është jo vetëm për t'u dhënë dinjitetin e mohuar të zhdukurve nga diktatura, por edhe bërja e vetë procesit sa më dinjitoz në tërësi. Kjo iniciativë pozitive është në hapat e para.

b. Ndjekja penale

Pandërshkueshmëria për zhdukjet me forcë është burim për shkelje të reja në të ardhmen. Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë nënkupton garanci për viktimat për një shpërblim të drejtë që nënkupton një hetim të plotë dhe tërësor me qëllim identifikimin e të gjithë personave të dyshuar për zhdukjen dhe dhënien e dënimeve përkatëse penale²³.

Ndjekja penale në këtë kontekst përfshin rastet e kryerjes së veprës penale të “Zhdukjes me Forcë” sipas nenit 109/c dhe “Fshehja ose asgjësimi i kufomës” sipas nenit 303 të Kodit Penal, për shkak të karakterit vazhdues të këtij krimi. Autoriteti gëzon të drejtën për të referuar në prokurori kryejën e veprave penale të lartpërmendura. Vlen të theksohet që e drejta për ushtrimin e ndjekjes penale kryesisht, nuk është ushtruar në asnjë rast nga ana e Prokurorive, ndaj krimeve të regjimit komunist.

Numri i rasteve sipas nenit 200 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale për zhvarrimin dhe identifikimin e kufomave të raportuara si të zhdukura mbetet dukshëm nën pritshmëritë e familjarëve dhe ligjvënësit.

²³ [Preliminary observations of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances at the conclusion of its visit to Albania \(5-12 December 2016\) | OHCHR, https://www.ohchr.org/en/statements/2016/12/preliminary-observations-working-group-enforced-or-involuntary-disappearances](https://www.ohchr.org/en/statements/2016/12/preliminary-observations-working-group-enforced-or-involuntary-disappearances)



Një nga arsyet që ka ndikuar është edhe ecuria (rezultatet) e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend. Zbatimi i këtij procesi ka përkuar me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të reja ligjore. Referuar raportit të KPK²⁴, 103 prokurorë janë shkarkuar (dhe 155 janë konfirmuar) nga detyra që nga fillimi i këtij procesi duke passjellë mungesa të theksuara në burimet njerëzore në prokuroritë e shkallës së parë. Për sa më sipër, burimet natyrshëm janë fokusuar në çështje më të ngutshme referuar afateve ligjore, si dhe tek veprat penale me efekt më të madh shoqëror. Përfundimi i këtij procesi dhe mbushja e sistemit me magjistratë të rinj, krijojnë premisa më pozitive për zbatimin e ndryshimeve ligjore.

Rezulton që në vitin 2019 është urdhëruar një gjermim/zhvarrosje nga prokurori i Rrethit Gjyqësor Sarandë bazuar në informacionet e dhëna nga një anëtar i familjes në lidhje me ish-kampin e burgut në fshatin Borsh të Rrethit të Sarandës. Mbetjet njerëzore të një individi, që besohet të jenë një prej të zhdukurve nga epoka komuniste, u zhvarrosën në tetor 2019. Prokurori dërgoi një kërkesë në laboratorin e ADN-së të Institutit të Policisë Shkencore për testimin e ADN-së. Sidoqoftë, laboratori i ADN-së i Institutit të Policisë Shkencore raportoi se nuk ishte në gjendje të përpunonte kampionin e ADN-së pas vdekjes të marrë nga mbetjet për shkak të mungesës së kapaciteteve teknike²⁵.

Një rast tjetër, i ndodhur në Fier në 2018 dhe i evidentuar nga përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme në eventin e datës 5 Mars 2024, përbën një shembull tjetër të ‘ngecjes, së procedurave penale. Ky rast nuk përbën një procedim penal në emër dhe ndaj një personi nën hetim; por u konstatua mungesë bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe njësisë së qeverisjes vendore, situatë e cila passolli mungesën e ekzekutueshmërisë së urdhërit të ekzekutimit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit për qëllime të hartimit të këtij Raporti si dhe për të kuptuar ecurinë e zbatimit të ligjit dhe rasteve në praktikë, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, ka paraqitur kërkesa për informacion në të 13 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (Tiranë, Shkodër, Dibër, Kukës, Durrës, Lezhë, Sarandë, Korçë, Elbasan, Fier, Berat, Gjirokaster, Vlorë). Objekti i marrjes së informacionit ka qenë:

1. *Numrin e procedimeve penale për kryerjen e veprës penale të “Zhdukjes me Forcë” parashikuar nga neni 109/c i Kodit Penal dhe vepra të tjera të ngjashme me to dhe që*

²⁴ Raport statistikor Shkurt 2018-Shkurt 2024 <https://kpk.al/wp-content/uploads/2024/03/raporti-statistikor-shkurt-2018-shkurt-2024.pdf>

²⁵ Raport i ICMP “Shqipëri, Personat e Zhdukur gjatë Periudhës Komuniste: Vlerësimi i Nevojave”, 2 Mars 2021, fq.12, <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-wb-152-6-alb-W-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>



ngarkojnë me përgjegjësi penale persona që kanë ndikuar në zhdukjen me forcë të personave të caktuar:

2. Numrin e rasteve ku janë ndërmarrë procedura ligjore sipas nenit 200 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale për zhvarrimin dhe identifikimin e kufomave të raportuara si të zhdukura.

Rezulton se kërkesave të KShH iu janë përgjigjur 11 Prokurori dhe përkatësisht: Prokuroria Sarandë, Korçë, Lezhë, Kukës, Diber, Tiranë, Gjirokaster, Elbasan, Fier, Durrës, dhe Berat ku sipas përgjigjeve të tyre ka rezultuar se nuk ka asnjë procedim penal që lidhet me nenin neni 109/c i Kodit Penal si dhe asnjë procedurë zhvarrimi të ndërmarrë dhe që lidhet me zhdukjet gjate periudhës së regjimit komunist. Ndërkohë nga Prokuroria Shkodër dhe Vlorë nuk ka patur përgjigje mbi informacionet e kërkuara.

Rasti i lartpërmendur mbetet i vetmi sipas të dhënave zyrtare të publikuara apo në dispozicion deri në momentin e hartimit të këtij Raporti.

2. Roli i shoqërisë civile

Fokusi i angazhimit të shoqërisë civile ka qenë kryesisht në çështjet e kompensimit dhe pronës. Tema e personave të zhdukur ka marrë vëmendje sporadike dhe jo të vazhdueshme. Edhe në ato raste kur ka patur angazhim, ato lidhen me aktivitete të natyrës përkujtimore dhe më pak për shkëmbimin e të dhënave me autoritetet shtetërore në mënyrë që të krijohen regjistrime të sakta mbi personat e zhdukur për qëllime historike dhe praktike. Mbetet e paqartë cili është niveli i informacionit që kanë ato organizata që janë marrë me çështjet e të përndjekurve, saktësia dhe përdorshmëria e tyre, si dhe në çfarë mase i janë vënë në dispozicion strukturave shtetërore. Në të gjitha rastet, mekanizimi koordinues i përmendur më sipër duhet të përfshijë edhe shoqërinë civile për të kuptuar kontributin e tyre në këtë proces.

Një shembull pozitiv është angazhimi i Fondacionit Kujto dhe dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare kujto.al. Kështu, Fondacioni ka hartuar një hartë të vendvarrimeve duke dhënë kështu një kontribut konkret. Sipas hartës vlerësohet se anash lumenjve, në male, pranë burgjeve, apo kampeve-burgje, pranë reparteve ushtarake, apo dhe pranë fshatrave të banuara, gjenden varre të humbura të përdorura nga ish-sigurimi i shtetit për pushkatimin dhe më pas varrosjen e kundërshtarëve politikë²⁶.

²⁶ <https://kujto.al/harta-e-vendvarrimeve/>. Harta e vendvarrimeve u mbështet nga “ICMP Small Grant project” në kuadër të projektit të Bashkimit Europian “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” të zbatuar nga ICMP-AIDSSH, financuar nga BE dhe Ambasada e Zvicrës në Tiranë.



IV. Rekomandime

Bazuar në të gjitha zhvillimet e përmendura më sipër (kuadri ligjor i rishikuar si dhe përpjekjet e ndërmarra nga AIDSSH), rekomandojmë hapat e mëposhtëm:

- Miratimi i akteve nënligjore normative që mundësojnë zbatimin tërësor të ligjit dhe veçanërisht në lidhje me ndarjen e qartë të kompetencave për të gjithë institucionet e përfshira;
- Krijimin e një mekanizmi koordinimi të qëndrueshëm, transparent dhe efektiv, si dhe një plan veprimi (*roadmap*) të dakordësuar midis të gjithë institucioneve, që përfshin shkëmbim periodik midis tyre si dhe tryeza teknike për të diskutuar sfidat e përbashkëta të tilla si identifikimi i zonave të mundshme për zhvarrosje, mënyrat e unifikuara të ruajtjes së tyre si dhe hartimin e një hartë qendrore të të gjithë këtyre vendndodhjeve. Ky proces shkon përtej nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis institucioneve.
- Shteti shqiptar duhet të sigurojë financimin e nevojshëm për zbatimin efektiv të kompetencave nga të gjithë institucionet e përfshira, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm tek AIDSSH, zyrat e prokurorive, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe bashkitë.
- AIDSSH duhet të vazhdojë përpjekjet për krijimin e një baze të dhënash të harmonizuar dhe tërësore për të gjithë personat e zhdukur. AIDSSH duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar integritet dhe besueshmëri të të dhënave. Në këtë kontekst, merr rëndësi të veçantë mbledhja e informacionit nga burime të ndryshme shtetërore dhe/ose private, kontrolli i ndërsjellët dhe analiza (e konsoliduar) me qëllim përfundimin e një informacioni që passjell hetim të suksesshëm.
- AIDSSH duhet të organizojë tryeza (trajtime) teknike me pjesëmarrjen e nëpunësve ligjzbatues, prokurorëve, gjyqtarëve dhe juristëve (avokatëve) që përfaqësojnë viktimat në lidhje me zbatimin e standardeve ndërkombëtare, karakteristikat e krimeve të zhdukjes së detyruar dhe hetimet përkatëse si dhe praktikën gjyqësore, duke përfshirë sensitivitetin e lartë në ndërveprimin me viktimat.
- Prokuroria e Përgjithshme duhet të forcojë përpjekjet për bashkëpunim me AIDSSH dhe policinë e shtetit në lidhje me hetimet proaktive në përputhje me ligjin.
- Ligjvënësi duhet të parashikojë mundësinë ligjore për familjet e viktimave në mënyrë që të përfitojnë nga skema e ndihmës ligjore falas dhe të promovojë pjesëmarrjen aktive të viktimave në hetimet zyrtare dhe proceset gjyqësore.
- Qeveria duhet të rrisë kapacitetet dhe infrastrukturën e Institutit të Mjekësisë Ligjore në mënyrë që të përmbushë detyrimet e parashikuara në ligj.



V. Literatura

Ligje të konsultuara

- Ligj nr. 9802, datë 13.9.2007, “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së ‘Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë’”;
- Marrëveshje Bashkëpunimi midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe ICMP për personat e zhdukur;
- Kodi i Procedurës Penale;
- Kodi Penal;
- Ligji nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ndryshuar;
- VKM nr.680, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të institutit të mjekësisë ligjore”;

Raporte

- Raport i ICMP “Shqipëri, Personat e Zhdukur gjatë Periudhës Komuniste: Vlerësimi i Nevojave”, 2 Mars 2021, <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-wb-152-6-alb-W-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>
- Preliminary observations of the Öorking Group on Enforced or Involuntary Disappearances at the conclusion of its visit to Albania (5-12 December 2016), <https://ëëë.ohchr.org/en/statements/2016/12/preliminary-observations-ëorking-group-enforced-or-involuntary-disappearances>
- Raporti Screening 2023 i Komisionit Evropian, 20 Korrik 2023 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_extern_al%20version.pdf
- Raport statistikor i KPK Shkurt 2018-Shkurt 2024 <https://kpk.al/wp-content/uploads/2024/03/raporti-statistikor-shkurt-2018-shkurt-2024.pdf>
- Raport vjetor AIDSSH për vitin 2022 <https://autoritetidosjeve.gov.al/uploads/raporti%20faqosje%202022%20print%20ok.pdf>
- Udhërrëfyes i AIDSSH <https://autoritetidosjeve.gov.al/files/uploads/Udherrefyesi-SHQIP-1.pdf>
- Protokolli i Burnemouth në gjuhën shqipe, <https://autoritetidosjeve.gov.al/files/uploads/Burnemouth-Protocol-Albanian-Final-Print.pdf>
- Vendimet e vëna në dispozicion nga AIDSSH për qëllime të këtij Raporti



Publikime të tjera

Fondacioni Kujto, “Kërkimet për viktimat e zhdukura të komunizmit, peng i përplasjes mes institucioneve”, <https://kujto.al/kerkimet-per-viktimat-e-zhdukura-te-komunizmit-peng-i-perplasjes-mes-institucioneve/>

Vendime të GJEDNJ-së

- Al-Skeini and Others v. the United Kingdom - 55721/07, datë 7.7.2011